

z. Ymer Fejzullahu  
Kryesues i Bordit të ZRrE  
Zyra e Rregullatorit për Energji

OPERATOR SISTEMI TRANSMISIONI DHE TREGU KOSTT sh.a  
TRANSMISSION SYSTEM AND MARKET OPERATOR KOSTT J.S.C  
OPERATOR SISTEMA PRENOSA I TRZIŠTA KOSTT d.d

Nr. 168 Dt. 22 01 2024  
PRISHTINË-A

22.01.2024

## Aplikacioni i KOSTT për azhurnimet vjetore të të hyrave të lejuara maksimale për vitin 2024

I nderuar z. Fejzullahu,

Zyra e Rregullatorit të Energjisë me datën 12 Dhjetor 2023 ka hapur procesin e azhurnimeve vjetore të të hyrave të lejuara maksimale për operatorët e rregulluar për vitin 2024 duke u bazuar në Rregullat për të hyrat e lejuara të të licencuarve.

KOSTT ka përgatitur aplikacionin për azhurnimet vjetore të të hyrave ku janë paraqitur të dhënat e realizuara për vitin 2023 si dhe parashikimet për vitin 2024.

Lusim Bordin e Zyrës së Rregullatorit për Energji për shqyrtimin dhe aprovimin e kërkesave të KOSTT.

Sinqerisht,




Evetar Zeqiri  
Kryeshef Ekzekutiv



Fëllënza Xhelili Fiçi  
Drejtor për Çështje Rregullative dhe Tarifa

Cc.

- znj. Lutfije Dervishi, Anëtare e Bordit të ZRrE,
- z. Gani Buqaj, Anëtar i Bordit të ZRrE,
- znj. Arta Qorolli, Anëtare e Bordit të ZRrE,
- z. Adnan Preniqi, Anëtar i Bordit të ZRrE
- z. Petrit Pepaj, Drejtor Menaxhues i ZRrE,
- z. Ymer Rudari, Udhëheqës i Departamentit për Tarifa në ZRrE,

	<b>APLIKACIONI PËR TARIFA</b>	<b>FO-ÇRT-012</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 1 nga 5</i>


22.01.2024

**Aplikacioni i KOSTT për azhurnimet vjetore të të hyrave të lejuara maksimale  
për vitin 2024**

Janar 2024

**Përmbajtja:**

1.0	Hyrje .....	3
2.0	Të Hyrat .....	3
3.0	Shpenzimet .....	3
3.1	Mirëmbajtja dhe shpenzimet tjera operative .....	3
3.2	Shpenzimet e Humbjeve në Transmision .....	4
3.3	Shpenzimet e Shërbimeve Ndhmëse .....	4
3.4	Mekanizmi ITC .....	5
4.0	Fondi për BRE .....	5
5.0	Përmbyllje .....	5

	<b>APLIKACIONI PËR TARIFA</b>	<b>FO-ÇRT-012</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 3 nga 5</i>

## 1.0 HYRJE

Zyra e Rregullatorit të Energjisë me datën 12 Dhjetor 2023 ka hapur procesin e azhurnimeve vjetore të të hyrave të lejuara maksimale për operatorët e rregulluar për vitin 2024 duke u bazuar në Rregullat për të hyrat e lejuara të të licencuarve.

KOSTT në vazhdim ka paraqitur të dhënat për kostot dhe të hyrat e realizuara për vitin 2023 si dhe kërkesat dhe parashikimet për vitin 2024.

Të dhënat e realizuara janë paraqitur sipas vitit kalendarik, të realizuara për 12 muaj.

## 2.0 TË HYRAT

Në bazë të Vendimit të Bordit të ZRrE-së, me nr. V\_1705\_2023 të datës 23.03.2023, të Hyrat e Lejuara për vitin relevant tarifor 1 prill 2023 – 31 mars 2024 për KOSTT kanë qenë 38,768,750 € kurse janë realizuar 36,800,437 euro.

Në tabelën më poshtë mund të shihen të dhënat për të hyrat e lejuara dhe të realizuara për vitin kalendarik 2023.

Tabela 1. Të Hyrat e Lejuara dhe të Realizuara të KOSTT në vitin kalendarik 2023


<b>Të Hyrat 2023</b>	<b>Njësia</b>	<b>Lejuara</b>	<b>Realizuara</b>	<b>%</b>
Të hyrat nga 400/220 kV	€000s	255.060	228.156	<b>89%</b>
Të hyrat nga 110 kV	€000s	13,479.274	13,202.901	<b>98%</b>
Të hyrat nga SO	€000s	24,727.463	23,081.946	<b>93%</b>
Të hyrat nga MO	€000s	306.953	287.434	<b>94%</b>
<b>Total të Hyrat</b>	€000s	<b>38,768.750</b>	<b>36,800.437</b>	<b>95%</b>

## 3.0 SHPENZIMET

Në vazhdim paraqiten të dhënat për shpenzimet e realizuara 2023 si dhe parashikimet për vitin 2024.

### 3.1 Mirëmbajtja dhe shpenzimet tjera operative

Në vitin 2023 për kategorinë e mirëmbajtjes kanë qenë të lejuara 689.670 euro kurse janë realizuar 506,009.69 euro. Për shpenzime tjera operative vlera e lejuar ishte 7,090,840.00 euro, ndërsa vlera e realizuar është 6,427,901.32 euro. Kurse sa i përket kategorisë ligjore të

	<b>APLIKACIONI PËR TARIFA</b>	<b>FO-ÇRT-012</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 4 nga 5</i>

shpenzimeve për sigurim shëndetësor si OPEX i pakontrollueshëm, të lejuara ishin 114,800.00 euro kurse janë realizuar 112,176.93 euro.

### 3.2 Shpenzimet e Humbjeve në Transmision

Gjendja aktuale sa i përket koston së humbjeve në transmision është si vijon. Niveli i realizuar i humbjeve në transmision është 114.43 GWh i shprehur në vlerë financiare 8,941,624.53 euro.

Humbjet e parashikuara për vitin 2024 sipas janë 139.18 GWh kurse kostoja e parashikuar e këtyre humbjeve është 8,806,839.76 euro. Kalkulimi i kësaj vlere është bërë duke përfshirë çmimin prej 39.10 €/MWh nga furnizimet prej KEK sh.a. duke u bazuar në shkresën e pranuar prej tyre me datë 29.12.2023, ku kërkohet që ky çmim të llogaritet nga data 01.04.2024 pasi që kostoja e prodhimit vazhdimisht është ngritur. Kurse sa i përket çmimit të parashikuar nga importi ato janë marrë nga parashikimet e bursës EEX German Power Futures.

### 3.3 Shpenzimet e Shërbimeve Ndhmëse


Për vitin 2023 për shpenzimet e shërbimeve ndihmëse janë lejuar 8,638,378.60 euro kurse janë realizuar 17,777,048.75 euro, si pasojë e ngritjes së çmimeve të shërbimeve ndihmëse si dhe nivelit të aktivizimit të rezervave si pasojë e devijimeve të larta të sistemit.

Në vazhdim është paraqitur parashikimi i këtyre shpenzimeve për vitin 2024 që është 20,085,000.00 euro.

Kalkulimi për koston e kapacitetit për rregullimin terciar mFRR në ngritje (+150 MW) dhe zbritje të kapacitetit prej (-30 MW), si dhe rregullim sekondar aFRR (+/-25 MW) (Automatic Frequency Restoration Reserves), për vitin 2024 është paraparë në vlerë prej 20,085,000.00 euro.

Tabela 2. Kalkulimi i koston së shërbimeve ndihmëse për vitin 2024

Kosto e kapacitetit ne realizim për shërbime ndihmëse aFRR (±25 MW) dhe mFRR në ngritje (+150 MW) dhe zbritje (-30 MW)							
Muaji	kapaciteti (MW)	ditë/muaj	aFRR ngritje 30.00 €/MW	aFRR zbritje 20.00 €/MW	mFRR ngritje 6.452 €/MW	mFRR zbritje 2.5 €/MW	Gjithsej
Janar	25.0	31	558,000.00 €	372,000.00 €	720,049.32 €	55,800.00 €	1,705,905.32 €
Shkurt	25.0	28	504,000.00 €	336,000.00 €	650,367.12 €	50,400.00 €	1,540,820.12 €
Mars	25.0	31	558,000.00 €	372,000.00 €	720,049.32 €	55,800.00 €	1,705,905.32 €
Prill	25.0	30	540,000.00 €	360,000.00 €	696,821.92 €	54,000.00 €	1,650,876.92 €
Maj	25.0	31	558,000.00 €	372,000.00 €	720,049.32 €	55,800.00 €	1,705,905.32 €
Qershor	25.0	30	540,000.00 €	360,000.00 €	696,821.92 €	54,000.00 €	1,650,876.92 €
Korrik	25.0	31	558,000.00 €	372,000.00 €	720,049.32 €	55,800.00 €	1,705,905.32 €
Gusht	25.0	31	558,000.00 €	372,000.00 €	720,049.32 €	55,800.00 €	1,705,905.32 €
Shtator	25.0	30	540,000.00 €	360,000.00 €	696,821.92 €	54,000.00 €	1,650,876.92 €
Tetor	25.0	31	558,000.00 €	372,000.00 €	720,049.32 €	55,800.00 €	1,705,905.32 €
Nëntor	25.0	30	540,000.00 €	360,000.00 €	696,821.92 €	54,000.00 €	1,650,876.92 €
Dhjetor	25.0	31	558,000.00 €	372,000.00 €	720,049.32 €	55,800.00 €	1,705,905.32 €
Total			6,570,000.00 €	4,380,000.00 €	8,478,000.00 €	657,000.00 €	<b>20,085,000.00 €</b>

	<b>APLIKACIONI PËR TARIFA</b>	<b>FO-ÇRT-012</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 5 nga 5</i>

### 3.4 Mekanizmi ITC

Gjatë vitit 2023 të hyrat nga mekanizmi ITC ishin 776,957.61 euro kurse shpenzimet 1,971,371.7 euro, që e vendos KOSTT-in në pozicion neto negativ prej (1,194,414.09) euro.

### 4.0 FONDI PËR BRE

Në vazhdim janë paraqitur të dhënat për të hyrat dhe shpenzimet e realizuara të Fondit për BRE. Të njëjtat do të përcillen edhe në formatin Excel.

Tabela 4. Të hyrat dhe shpenzimet e Fondit për BRE gjatë vitit 2023

2023	Njësia	Të hyrat	Shpenzimet	Mbetja
Fondi për BRE	€000s	46,966.934	51,924.909	(4,957.975)

Duhet theksuar se gjatë këtij procesi duhet të azhurnohen të hyrat e Fondit për BRE edhe për një pjesë të të hyrave të vitit 2023, ku mbetja në fond është llogaritur 4,463,743 €, ndërsa mbetja reale ka qenë 1,235,720.19 euro.

### 5.0 PËRMBYLLJE

KOSTT ka paraqitur të gjitha të dhënat për realizimet dhe parashikimet e kostove për vitin 2023 dhe vitin 2024, duke shpresuar se të gjitha kërkesat dhe sqarimet do të merren parasysh.

Bashkëngjitur do të përcillen formularët raportues të ZRrE të plotësuar sipas kërkesës.

- Fundi i Dokumentit -